



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 145 Prot.

Tiranë, më 30.01 2018

VENDIM Nr. 14, datë 18.01.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.1, datë 18.01.2018, pasi shqyrtoi *Konceptin e sondazheve arkeologjike* për sheshin ku do zhvillohet projekti "*Godinë banimi dhe shërbimesh 2 kat mbi tokë dhe 2 kat nëntokë*" *Lagjia Nr. 1, rruga "Anastas Durrësaku", në zonën arkeologjike "B"* të qytetit të Durrësit, pronar Z. Bledar Shuaipi, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k., në vijim të vendimit të KKA Nr. 85, datë 26.04.2017,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Konceptin e sondazheve arkeologjike* për sheshin ku do zhvillohet projekti "*Godinë banimi dhe shërbimesh 2 kat mbi tokë dhe 2 kat nëntokë*" *Lagjia Nr. 1, rruga "Anastas Durrësaku", në zonën arkeologjike "B"* të qytetit të Durrësit, pronar Z. Bledar Shuaipi, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.
2. Subjekti Bledar Shuaipi duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila do të realizojë sondazhin arkeologjik, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri. Raporti i tij do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Investitori si dhe shoqëria e licencuar në arkeologji, e cila do të kryejë sondazhin arkeologjik, në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar) Rregullores "Mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut" dhe akt-marrëveshjes tre

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

palëshe të sipërcituar, janë të detyruar të marrin të gjitha masat për sigurimin dhe ruajtjen e kantierit, si dhe ruajtjen e strukturave arkeologjike, të cilat mund të zbulohen gjatë kryerjes së sondazhit, deri në vendimmarjen përfundimtare të KKA, në lidhje me to.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTRE



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO